



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	05-03/19	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01 N1060/01-4976/19				



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

**PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-**

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së II (Dytë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 27 Shkurt 2019.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e II (Dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 27 Shkurt 2019, dhe atë:

1. Vendimi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2018, në vitin 2019 / Lënda : 01Nr. 05-400/01-4632/19;
2. Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, parcelës kadastrale Nr. 00078-2 ZK Kaçanik, me kulturë, Livadh i klasës së 4 (Katërt) në pronësi të Milaim Dogani/ Lënda: 01Nr. 06-351/02-36277/19;
3. Vendimi për lejimin e mjeteve buxhetore nga subvencionet, për realizimin e projekteve të DAK për vitin 2019/Lënda: 01Nr. 400/01-5157/19;
4. Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK, për ndarjen e masës drusore të konfiskuara familjeve skamnore/ Lënda: 01Nr. 322/01-5692/19;
5. Vendimin për Lejimin e mjeteve buxhetore për xhirimin e filmit “ Ne kërkim të Venerës” / Lënda: 01Nr. 060/03-4584/19;
6. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 060/01-4631/19; dhe
7. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019 / Lënda: 01 Nr. 60/01-5181/19.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 05-400/01-4632/19
Kaçanik, 27.02.2019

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 9 të Ligjit Nr.06/L-133 (Gazeta Zyrtare Nr. 4/14 Shkurt 2019).- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 si dhe nenit 34.5 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë: 27 Shkurt 2019, mori këtë:

V E N D I M
PËR BARTJEN E MJETEVE VETANAKE BUXHETORE TË PA SHPENZUARA
NGA VITI FISKAL 2018, NË BUXHETIN E KOMUNËS TË VITIT 2019

1. Me këtë Vendim, bëhet bartja e mjeteve të vetanake të pashpenzuara nga viti fiskal 2018, në buxhetin e komunës të vitit 2019.
2. Buxheti i Komunës së Kaçanikut i miratuar për vitin 2019 në shumë, **8,381.634.00 €**, pas bartjes së mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2018, nga viti fiskal 2019 në shumë, **285.701.49 €**, do të arrijnë shumën e përgjithshme, **8,667,355.49 €**.
3. Mjetet e pa shpenzuara në shumë, **285,701.49 €**, barten si vijon:
 - 3.1. Për Mallra dhe Shërbime shuma,**2,937.88 €**;
 - 3.2. Për Shpenzime Komunale shuma**4,500.00 €**;
 - 3.3. Subvencione dhe Transfere shuma**4,273.56 €**; dhe
 - 3.4. Investime Kapitale shuma**273,990.05 €**.
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë; Shtojcat A dhe B të pesë (05) pasqyrave tabelave e bilanceve të pa shpenzuara nga viti fiskal 2018 dhe rindarja e mjeteve të bartura në buxhetin e vitit 2019 në Nën-programet përkatëse, kategoritë ekonomike dhe kodet e projekteve.
5. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njëjtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim të njoftohen:

1. Kryetari i Komunës(përmes Zyrës së Kryetarit, njoftohen shërbimet tjera)
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseki



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Departamenti i Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit
Departament za Ekonomiju, Finansije i Razvoja
Department of Economy, Finance and Development

Nr. 05- Nr. 400/01-4632/2019

Kaçanik; 25.02.2019

PËR/ZA/TO:	KUVENDIN KOMUNAL – KRYESUESIN Z.KEMAL MËRSELI
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Bahri Selimi –Drejtore për Buxhet dhe Financa
NGA/OD/FROM:	Besim Ilazi – Kryetar Komune-ZKA
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i kërkesës për shqyrtim dhe miratim të bartjes së mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2018 në buxhetin e vitit 2019 me përmirësime sipas kërkesave nga anetaret e KPF-së

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, bashkëngjitur ju dërgojmë tabelat prej 1 deri 5 lidhur me bilancet e pashpenzuara të hyrave vetanake të viteve paraprake, të cilat duhet të barten në vitin 2019.

Gjithësej shuma e mjeteve të pa shpenzuara të vitit 2018 nga të Hyrat Vetanake Komunale (HVK), të cilat duhet të barten për shfrytëzim në vitin 2019 janë në shumë prej: **285,701.49euro**.

Shpërndarja e mjeteve të pashpenzuara bëhet si vijon:

- Mallra e Sherbime, shuma 2,937.88 €
- Sherbime komunale, shuma 4,500.00 €
- Subvencione e transfere, shuma 4,273.56 € dhe
- Investime kapitale, shuma 273,990.05 €

PASQYRA TABELARE
E MJETEVE TË PASHPENZUARA TË VITIT 2017 DHE 2018
SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE

1/. HVK-të e pa shpenzuara të vitit 2017

Tabela 1.

Nr.	Programet Buxhetore	Pagat	Mallra dhe Shërbime	Shërbime Komunale	Subvencione & Transfere	Investime Kapitale	Totali :
1	Administrata - Nënprogrami 16328	-	262.61			1,441.12	1,703.73
2	Buxheti - Nënprogrami 17528	-				16,583.71	16,583.71
3	Pl.dhe Zhvillimi Ekonomik - Nënprogrami 48028	-				2,847.76	2,847.76
4	Shërb.Publike, MC dhe Emergj. - Nënprogrami 18028	-				12,698.93	12,698.93
5	Shëndetësia dhe MS. - Nënprogrami 74700	-	4.18			6,776.56	6,780.74
6	Kultura, rinia dhe sportet - Nënprogrami 85028	-				30,674.31	30,674.31
7	Arsimi dhe Shkenca - Nënprogrami 92140	-	0.64		26.85	3,576.80	3,604.29
8	Arsimi Fillor - Nënprogrami 93810	-				-	-
T O T A L I :		-	267.43	-	26.85	74,599.19	74,893.47

2/. HVK-të e pa shpenzuara të vitit 2018

Tabela 2.

Nr.	Programet Buxhetore	Pagat	Mallra dhe Shërbime	Shërbime Komunale	Subvencione & Transfere	Investime Kapitale	Totali :
1	Buxheti - Nënprogrami 17528	-				80,015.25	80,015.25
2	Administrata dhe Personeli - Nënprogr.16328	-				361.00	361.00
5	Pl.dhe Zhvillimi Ekonomik - Nënprogrami 48028	-			4,000.00	42,631.32	46,631.32
6	Shërb.Publike, MC dhe Emergj. - Nënprogr.18028	-	1,141.76			33,969.83	35,111.59
8	Bujqësi-Pylltari - Nënprogrami 47028	-			147.00	11,342.00	11,489.00
9	Planifikim Urban dhe Mjedis - Nënprogrami 66445	-				2,686.80	2,686.80
10	Shërb.e kujdesit prim.shëndetsor - Nënprogrami 74700	-	-	3,000.00		6,404.00	9,404.00
11	Sherbimet rezidenciale-Nënprogrami 75637	-	924.00	1,500.00			2,424.00
12	Kultura, rinia dhe sportet - Nënprogrami 85028	-				8,784.50	8,784.50
13	Arsimi dhe Shkenca - Nënprog.92140	-			99.71	13,196.16	13,295.87
14	Arsimi Para Fillorë - Nënprogrami 92751	-	604.69			-	604.69
T O T A L I :		-	2,670.45	4,500.00	4,246.71	199,390.86	210,808.02

C/. PËRMBLEDHJA (A+B) :

Tabela 3.

Nr.	Programet Buxhetore	Pagat	Mallra dhe Shërbime	Shërbime Komunale	Subvencione & Transfere	Investime Kapitale	Totali :
1	Administrata dhe Personeli - Nënprogrami 16328	-	262.61			1,802.12	2,064.73
2	Buxhet dhe Financa - Nënprogrami 17528	-	-			96,598.96	96,598.96
3	Shërb.Publike dhe Emergj. - Nënprogrami 18028	-	1,141.76			46,668.76	47,810.52
4	Pl.dhe Zhvillimi Ekonomik - Nënprogrami 48028	-	-		4,000.00	45,479.08	49,479.08
5	Bujqësi-Pylltari - Nën programi 47028	-	-		147.00	11,342.00	11,489.00
6	Planifikimi Urban dhe Mjedis - Nënprogrami 66445	-	-			2,686.80	2,686.80
7	Shërb.e kujdesit prim.shëndetsor - Nënprogrami 74700	-	4.18	3,000.00		13,180.56	16,184.74
8	Sherbimet rezidenciale - Nënprogrami 75637	-	924.00	1,500.00		-	2,424.00
9	Kultura, rinia dhe sportet - Nënprogrami 85028	-	-			39,458.81	39,458.81
10	Arsimi dhe Shkenca - Nënprogrami 92140	-	0.64		126.56	16,772.96	16,900.16
11	Arsimi Para Fillorë - Nënprogrami 92751	-	604.69			-	604.69
T O T A L I :		-	2,937.88	4,500.00	4,273.56	273,990.05	285,701.49



SHTOJCA - B : Rindarja e mjeteve të bartura në 2019

PASQYRA TABELARE

**PËR RISHPERNDARJEN E MJETEVE TË PASHPENJUARA TË VITIT 2017 DHE 2018, NË VITIN 2019
(SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE)**

Tabela 4.

Nr.	Programet Buxhetore	Pagat	Mallra dhe Shërbime	Shërbime Komunale	Subvencione & Transfere	Investime Kapitale	Totali :
1	Buxhet e Financa Nënprogrami 17528	-				25,809.49	25,809.49
2	Planifikimi dhe Zhv.Ekonomik - Nënprogrami 48028	-				10,000.00	10,000.00
3	Planifikimi Urban dhe Mjedisi - Nënprogrami 66445	-				10,000.00	10,000.00
4	Shërb.Publike, MC dhe Emergj. -Nënprogr.18028	-				65,000.00	65,000.00
5	Shërb.e Shëndetësisë Primare - Nënprogrami 74700	-		3,000.00		13,180.56	16,180.56
6	Shërbimet rezidenciale - Nënprogrami 75637	-		1,500.00		-	1,500.00
7	Shërb.Kulturore - Nënprogrami 85028	-				15,000.00	15,000.00
8	Arsimi Para Fillorë - Nënprogrami 92751	-	604.69			-	604.69
9	Arsimi dhe Shkenca - Nënprogrami 92140	-	2,333.19		4,273.56	135,000.00	141,606.75
	T O T A L I :	-	2,937.88	4,500.00	4,273.56	273,990.05	285,701.49

► SHPËRNDARJA E MJETEVE PËR INVESTIMEVE KAPITALE (22/300) SIPAS KODEVE EKONOMIKE DHE KODEVE TË PROJEKTEVE NË SHUMË
TOTALE PREJ 273,990.05€, DO TË BËHET SIPAS KËSAJ PASQYRE TABELARE:

Tabela 5.

Nr.	INVESTIMET KAPITALE	Kodi Programit	Kodi i Projektit	Shuma :
1	Renovimi i objektit të shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurta"	85028	48562	15,000.00
2	Renovimi i objekteve dhe infrastruktures shëndetësore	74700	46820	13,180.56
3	Ndërtimi i stadiumit të qytetit "Besnik Begunca"	92140	45064	45,000.00
4	Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në fshatin Kovaçec	92140	90405	60,000.00
5	Renovimi i objekteve dhe infrastruktures shkollore	92140	86263	20,000.00
6	Rregullimi dhe funksionalizimi i kabineteve shkollore	92140	48671	10,000.00
7	Rregullimi i rruges Shaban Elezi - Sllatinë	48028	45364	10,000.00
8	Rregullimi i rrugëve në fshatin Kovaçec	18028	46631	10,000.00
9	Asfaltimi i rrugëve të lagjes Tushaj - Soponicë	18028	48283	20,000.00
10	Ndërtimi i rrugëve - Kotlinë	18028	46642	15,000.00
11	Ndërtimi i rrugëve në Fshatin Begracë	18028	46607	10,000.00
12	Asfaltimi i rrugës Beteja e 25 Majit (segmenti Sepetin-Imisht)	18028	48242	10,000.00
13	Ndërtimi i shtreterve të lumenjëve të qytetit: Lepenc, Nerodime	66445	48400	10,000.00
14	Mjetet për shpronësime	17528	43973	2,502.00
15	Mjetet për bashkëfinancim të projekteve	17528	86245	23,307.49
	Totali (1deri 16) :			273,990.05





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01.Nr. 06-351/02-36277/19
Kaçanik, 27.02.2019

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 10.2 dhe 10.3 të Ligjit 02/L-26 –Për Tokën Bujqësore, të nenit 6.2 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 –Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të Propozim Vendimit të DUKMM 06 Nr. 351/02-36277/19 – Për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 00078-2, me Kulturë Bujqësore, Livadh i klasës së 4 (Katërt) në Zonën Kadastrale, Kaçanik, në pronësi të Milaim Dogani, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 27 Shkurt 2019, mori këtë:

V E N D I M PARAPRAK PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS

1. Me këtë Vendim, merret Vendim Paraprak -Për ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore, në Tokë Ndërtimore.
2. Toka me destinim bujqësor e lejuar për ndërrimin e destinimit nga pika 1. e këtij Vendimi, lejohet në parcelën kadastrale **00078-2**, me Kulturë Bujqësore Livadh i klasës së 4 (Katërt), me sipërfaqe **998m²**, e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me Nr. P-70917048-00078-2, në Zonën Kadastrale Kaçanik, në vendin e quajtur, Dushkajë, në pronësi të, Milaim (Mehmet) Dogani, destinohet në tokë ndërtimore.
3. Parcela Kadastrale si në pikën 1 të këtij Vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal në fuqi parashihet “tokë bujqësore” ndërkaq me këtë Vendim i ndërrohet destinimi në tokë ndërtimore dhe e njëjta bëhet pjesë përkatëse e PZHK.
4. Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të paguhet në procedurë administrative, sipas dispozitave nënligjore në fuqi që e përcaktojnë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
5. Para marrjes së vendimit përfundimtar për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të kërkohet, Pëlqimi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe organet tjera relevante, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
06Nr-351/02-36277/18
Kaçanik, 19.02.2019

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Kaçanikut duke u bazuar në nenin 10.5 pika a të Ligjit Nr.02/L-26, për Tokën Bujqësore; në bazë të nenit 6 pika 6.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, lidhur me kërkesën 06Nr-351/02-36277/18 për ndërrim destinimi të tokës bujqësore:

Propozon

Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin Komunal, që lidhur me kërkesën e z.Milaim Dogani nga Kaçaniku për ndërrim destinimi të tokës bujqësore(livadh i klasës së IV-të) në atë ndërtimore, të merr:

VENDIM PARAPRAK

Aprovohet kërkesa. 06Nr-351/02-36277/18 e datës 08.11.2018 e parashtruar nga z.Milaim Dogani për lejimin e ndërrimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore 998m², në parcelën kadastrale nr.P-70917048-00078-2, zona kadastrale Kaçanik, me kulturë Livadh i klasës së IV-të, me sipërfaqe 998m², pronë e Milaim Dogani.

Arsyetim

Në drejtorinë e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka arritur kërkesa me numër 06Nr-351/02-36277/18 për ndërrimin e destinimit nga toka me kulturë Livadh i klasës së IV-të, në tokë ndërtimore.

Sipas Planit Zhvillimor Komunal në fuqi parashihet "toka bujqësore"




Drejtori i drejtorisë
Ukeshin Çallaku

 REPUBLIKA E KOSOVËS	0101 - Formulari për kërkesë apo ankesë	 KAÇANIKU
	Drejtorati / Njesia Urbanizmit, Kadaster dhe Mjedis	Data (dita / muaji / viti)

1 Informatat personale të parashtruesit të kërkesës:			Mos shkruani në Pranuar nga: Numri i protokollit: <u>06-357/08-36277/8</u> Vendimi: po Nga: Data:
Emri dhe mbiemri <u>MILAIM DOGANI</u>	Lloji dhe numri i dokumentit identifikues _____		
Data e lindjes (dita / muaji / viti)	Adresa e vendbanimit <u>KAGJISTRAL- VAG-FER</u> (numri i shtëpisë/banesës, rruga, fshati/qyteti, kodi postar)		
Numri i tel. fiks	Numri i tel. mobil	E-mail adresa	

2 Selektlo llojin:	
Kërkesë ☒	Ankesë ☐

3 Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:
<i>Kërkoj nga DURUM që të më lejohet ndërrim-destinimin e tokës bujqësore në tokë industriale për p.l. 782 Ati. Kërkues</i>

4 Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi Unë <u>MILAIM DOGANI</u> vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta. (Emri i plotë i aplikuesit)	 (Nenshkrimi)
---	---

*** Ju lutemi të kërkonti nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura ***



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government


Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-70917048-00078-2	Parcelë / Parcela / Parcel	998,0
06-341-36242/2018		



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.11.2018

Koha/ Vreme/ Time: 09:10:20

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Shënim/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MEDIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGJENCIA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917048-00078-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 941-36270/2018
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 08.11.2018 - 09:07
Komuna / Opština / Municipality: Kaçanik / Kačanik / Kaçanik
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: KAÇANIK / KAČANIK / KAÇANIK
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Kaçanik / Kačanik / Kaçanik

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917048-00078-2	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna imovina Privately owned Land	Rural	998	13-1996		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
DUSHKAJA / DUSHKAJA DUSHKAJA		DUSHKAJA		



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Nuëri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Siqërtëqja Površina Area
1	Bujqësore/Poljoprivredno/ Agriculture	Livadhë/Livade meadow	Livadh 1 Klase 4 Livada 4 Klase 4th Class Meadow	998

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lienit broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Përkthimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseëdla individual / Individaalna Drzavina / single possessor	DOGANI MILAIMI (MEHMET)	KCID0905193	KAÇANIK / KAÇANIK KAÇANIK /		EMIN DURAJU	1/1	13-1996	



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 Nr. 400/01-5157 19
Kaçanik, 27.02.2019

Në mbështetje të nenit 12 lidhur me nenin 17 pika (h) dhe (r) të Ligjit Nr. 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), nenit 40 pika 4 e Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr. 04/L-032 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/16 Shtator 2011), të Rregullores Nr.05-39427/16 e dt. 21.12.2016 -Për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, si dhe nenit 34.5 lidhur me nenit 6 dhe 61.1 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 27 Shkurt 2019, mori këtë:

VENDIM

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Lejohet ndarja e mjeteve financiare nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në shumë prej 50,040.00 €, për realizimin e aktiviteteve arsimore, si në vijim:

1.1. Aktivitetet mësimore dhe jashtë mësimore (garat shtetërore dhe komunale) dhe shpërblime të ndryshme të Drejtorisë së Arsimit;

1.2. Transporti i nxënësve të shkollave fillore, shkollave të mesme, nxënësve me nevoja speciale, transporte dhe ekskursione të ndryshme; dhe

1.3. Bursa për studentë.

2. Lejohet ndarja e mjeteve financiare nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në shumë prej 57,000.00 €, për realizimin e aktiviteteve kulturore, si në vijim:

2.1. Aktivitete kulturore; dhe

2.2. Subvencionimi i Shoqërive Kulturore e Artistike, Klubet sportive dhe OJQ-ve.

3. Mjetet buxhetore nga pika 1. e këtij Vendimi, sigurohen nga programi buxhetor i Drejtorisë së Arsimit, përkatësisht nga kategoria buxhetore Subvencione dhe Transfere.

4. Mjetet buxhetore nga pika 2. e këtij Vendimi, sigurohen nga programi buxhetor Shërbime Kulturore, përkatësisht nga kategoria buxhetore Subvencione dhe Transfere.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, respektivisht 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Drejtoria e Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Këmal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Kryetari i Komunës
01-Nr. 400/01-5157/19
Kaçanik, 21.02.2019

Në mbështetje të nenit 58 pika (h), nenit 17 pika (h) dhe (r) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, të Rregullores Nr.05-39427/16 e dt. 21.12.2016 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nenit 40 pika 4 e Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04 L\ 047, si dhe nenit 73 të Statutit të komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës, bënë këtë:

PROPOZIM -VENDIM **Për lejimin e mjeteve financiare**

1. Lejohet ndarja e mjeteve financiare nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në shumë prej **50,040.00 €**, për realizimin e aktiviteteve arsimore, si në vijim:

1.1. Aktivitetet mësimore dhe jashtë mësimore (garat shtetërore dhe komunale) dhe shpërblime të ndryshme të Drejtorisë së Arsimit.

1.2. Transporti i nxënësve të shkollave fillore, shkollave të mesme, nxënësve me nevoja speciale, transporte dhe ekskursione të ndryshme.

1.3. Bursa për studentë.

2. Lejohet ndarja e mjeteve financiare nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në shumë prej **57,000.00 €**, për realizimin e aktiviteteve kulturore, si në vijim:

2.1. Aktivitete kulturore,

2.2. Subvencionimi i Shoqërive Kulturore e Artistike, Klubet sportive dhe OJQ-ve.

3. Mjetet buxhetore nga pika 1. e këtij Vendimi, sigurohen nga programi buxhetor i Drejtorisë së Arsimit, përkatësisht nga kategoria buxhetore Subvencione dhe Transfere.

4. Mjetet buxhetore nga pika 2. e këtij Vendimi, sigurohen nga programi buxhetor Shërbime Kulturore, përkatësisht nga kategoria buxhetore Subvencione dhe Transfere.

5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi komunës.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Drejtoria e Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit.

7. Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.

Kryetari i Komunës;
Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 Nr. 322/01-5692/19
Kaçanik, 27. 02.2019

Në bazë të nenit 12 dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) të nenit 29.12(b) të Ligjit Nr. 03/L -153/2010-Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/3-Për Pyjet e Kosovës, të nevojave të shkollave të Komunës për lëndë djegëse-dru, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 27 Shkurt 2019, mori këtë:


VENDIM

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01 Nr. 08-322/01-39890/18 PËR NDARJEN E MASËS DRUSORE TË KONFISKUAR FAMILJEVE SKAMNORE

1. Me këtë Vendim bëhet, Ndryshim Plotësimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr. 08-322/01-39890/18 -Për ndarjen e masës drusore të konfiskuar familjeve skamnore, i datës 27 Dhjetor 2018, për shkak të pamundësisë së ekzekutimit të vendimit, ashtu që me ndryshimet e bëra të vendimit, drutë e konfiskuara iu ndahen, shkollave të komunës.
2. Ndryshimet e Vendimit si në pikën 1. bëhen me këtë formulim:
 - 2.1. Hiqet pasuesi "Familjeve Skamnore" si të baza ligjore, emërtimi i vendimit si dhe të pikët: 1. dhe 3. , ndërkaq shtohet pasuesi, " Shkollave të Komunës".
 - 2.2. Të pika 2. e Vendimit, hiqet pasuesi "Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale" shtohet " Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës".
3. Pikët tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës si dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari;
3. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës;
4. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; dhe
5. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



I	Data 26.02.19	Vendi
Nj. org.	Numri	Shtojcë
09	322/09-J692	

Bazuar në nenin 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 3 dhe neni 73 pika 2 të Statutit të Komunës së Kaçanikut Kryetari i Komunës së Kaçanikut:

PROPOZON

që në bazë të nenit 12 pika 12.1 dhe nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut lidhur me masën drusore të konfiskuara për vitin 2018, të merr këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIN 01.Nr.08-322/01-39890/18, të datës 27.12.2018 PËR NDARJEN E MASËS DRUSORE TË KONFISKUARA SHKOLLAVE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT

- I. Lejohet ndarja e masës drusore të konfiskuara gjatë vitit 2018 që ndodhen në Autoparkun e Invalidëve të luftës atyre shkollave të Komunës së Kaçanikut të cilat si lëndë djegëse për ngrohje përdorin masën drusore.
- II. Obligohet DBZHRP që të bëjë mbikëqyrjen e shpërndarjes së masës drusore që gjenden në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të luftës.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë si dhe Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Më datën 27.12.2018 Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka marrë vendim për ndarjen e masës drusore të konfiskuara gjatë vitit 2018 për familjet skamnore, por masa drusore ka qenë e pamjaftueshme për t'i përmbushur kërkesat dhe nevojat që janë paraqitur. Andaj, duke marrë parasysh mungesat e mëdha të masës drusore për ngrohje në shkolla, ndalimin e përdorimit të thëngjillit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Kryetari i Komunës së Kaçanikut propozon që të vendoset si në dispozitiv të këtij Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuara 54.81 metër hapësinore sipas marrëveshjes me Shoqatën e Invalidëve të Luftës (60% Komunës dhe 40% SHIL) që janë të vendosura në Autoparkun e SHIL-it.

Kaçanik, 26.02.2019

Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 08-322/01-39890/18
Kaçanik, 27.12.2018

Në bazë të nenit 12 dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) të nenit 29.12(b) të Ligjit Nr. 03/L -153/2010-Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/3-Për Pyjet e Kosovës, të nevojave të qytetarëve (familjeve skamnore) të Komunës për lëndë djegëse-dru, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 27 Dhjetor 2018, mori këtë:

VENDIM
PËR NDARJEN E MASËS DRUSORE TË KONFISKUAR
FAMILJEVE SKAMNORE

1. Me këtë Vendim, Lejohet ndarja e masës drusore të konfiskuara në vitin 2018 që ndodhen në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës, Familjeve skamnore të Komunës së Kaçanikut.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset; drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltarisë, si dhe drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

3. Obligohen dy drejtoritë si në pikën 2 të këtij Vendimi, t'i marrin veprimet e nevojshme që masës drusore të konfiskuar që ndodhet në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës, t'ua ndajnë familjeve skamnore, ndërkaq për mënyrën e ndarjes, të bëjnë me shkrim një Informatë duke ia bashkangjitur edhe Listën e përfitueseve të masës drusore të konfiskuar, më të cilën shkresë do të njoftohet edhe Kuvendi i Komunës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari;
3. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; dhe
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 060/03-4584/2019
Kaçanik, 27.02.2019

Në mbështetje të nenit 12 lidhur me nenin 17 pika (r) të Ligjit Nr. 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të Rregullores Nr.05-39427/16 e dt. 21.12.2016 -Për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, si dhe nenit 34.5 lidhur me nenin 6 dhe 61.1 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 060/93-4584/19, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 27 Shkurt 2019, mori këtë:

VENDIM

PËR MBËSHTJETJE ME MJETE BUXHETORE “CIRCLE PRODUCTION SH.P.K” PËR XHIRIMIN E FILMIT “NË KËRKIM TË VENERËS”

1. Me këtë Vendim, Lejohet ndarja e mjeteve financiare nga buxheti i Komunës së Kaçanikut, në shumë 3,000.000(tremijë euro) “Circle Production SH.P.K” nga Prishtina, me producentin, Besnik Krapë -Për mbështetje të xhirimit të filmit artistik të metrazhit të gjatë “ Në kërkim të Venerës”.
2. Mjetet buxhetore nga pika 1. e këtij Vendimi, do të sigurohen nga Subvencionet e drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës Sektori i Kulturës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, respektivisht 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Drejtoria e Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Zyra e Kryetarit



Në mbështetje të nenit 58, pika h), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 73 pika 5 i Statutit të Komunës së Kaçanikut Kryetari i Komunës së Kaçanikut,

Propozon

Në mbështetje të nenit 40 pika c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, kërkesës 01.Nr 060/03-4584 të datës 15/02/25019 të "Circle Production SH.P.K", Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 27/02/2019 të merr këtë:

V E N D I M

**PËR MBESHTETJE ME MJETE BUXHETORE "CIRCLE PRODUCTION SH.P.K" PËR
XHIRIMIN E FILMIT "NË KËRKIM TË VENERËS"**

I.

Me këtë vendim lejohet ndarja e mjeteve financiare nga buxheti i Komunës së Kaçanikut në shumën 3,000.00 € (tremijë euro) për shpenzimet e xhirimit të filmit artistik "Në kërkim të Venerës".

II.

Mjetet buxhetore nga **pika I.** e këtij vendimi, do të sigurohen nga subvencionet të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës – sektori për kulturë.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim:

Më datë 15/02/2019, pranë qendrës për shërbime me qytetar është paraqitur Besnik Krapiproducent i "Circle Production SHPK" me ç'rast ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut mbështetje financiare në vlerë prej 5,400.00 Eurosh për realizimin e filmit artistik të metrazhit të gjatë "Në kërkim të Venerës".

Duhet pasur parasysh që ky film do të gjrohet në Komunën e Kaçanikut dhe rrjedhimisht Kaçaniku do të shndërrohet në shesh xhirimi për rreth një muaj dhe do të shfaqen bukuritë që ka ky qytet, andaj është shumë e rëndësishme që të votohet pro kësaj iniciative dhe të ndahen mjetet si në dispozitiv të këtij vendimi. Mjetet e arsyeshme nga ne janë paraparë të jenë 3,000.00 Euro.

Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data 15.02.19	Vendi Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	060103-4584	7

CIRCLE
P R O D U C T I O N

Circle Production sh.p.k.
Rr. Muharrem Fejza, Art Construction,
B1,H1,K7,F47 – 10000 Prishtinë
circleproduction.ks@gmail.com
besnik.krapi@gmail.com

datë: 13.02.2019

KËRKESË

Drejtuar:
Kryesuesit te Kuvendit Komunal – Kaçanik

Subjekti: Kërkesë për mbështetje për xhirimin e filmit "Në kërkim të Venerës"

I nderuar Kryesues,

Ju drejtohem në emër të ekipit të filmit „Në kërkim të Venerës, me skenar dhe regji të Norika Sefës, i cili është një koproduksion kosovaro- shqiptaro-çek, i subvencionuar nga Qendra kinematografike e Kosoves.

Ekipi i filmit do të ishte shumë mirënjohës nëse për këtë periudhë do te na mbulonit shpenzimet e qëndrimit dhe shpenzimet e xhirimit në disa lokacione në Kaçanik. Shuma e përafërt që na nevojitet për të mbuluar këto shpenzime është 5400 euro.

Ne jemi të bindur se përfitimet e Kaçanikut në këtë projekt do të jenë të shumta;
- promocioni që filmi do ti bëj qytetit të Kaçanikut gjatë xhirimit të filmit dhe pas përfundimit të tij,
- mjetet që do të shpenzohen në Kaçanik gjatë xhirimit të filmit,
- Angazhimi i shumë qytetarëve Kaçanikas në projekt,
- Paraqitja e lokacioneve shumë të bukura të Kaçanikut në film

Ekipi i filmit do të qëndrojë në Kaçanik nga data 20.02.2019 deri më 27.03.2019.

Në fund, dëshirojmë ta theksojmë që ndihma dhe mbështetja e juaj do të ishin të një rëndësie shumë të madhe për realizimin dhe xhirimin e këtij projekti të rëndësishëm filmik.

Me nderime,
Ekipi i filmit „Në kërkim të Venerës“
Besnik Krapi, Producent





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-4631/19
Kaçanik: 27.02.2019

Në bazë të nenit 57.1 dhe 57.2 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 27 Shkurt 2019, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR POLITIKË
DHE FINANCA PËR VITIN 2018

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 060/01/19- me tekstin e mëtejshëm "Raport Punë i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2018"
2. Raporti si në pikën 1 të këtij Vendimi përmban, pikësyzimet në lidhje me realizimin e detyrave nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe nivelin e realizimit të tyre lidhur me aktivitetin e zhvilluar për gjatë vitit 2018.
3. Raporti është përmbledhur në gjithsej, 9 faqe + ballina dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Kaçanik
Skupština Opština
Municipal Assambly
- Komiteti për Politikë dhe Financa-

01Nr. 601-4631/2019
Kaçanik, 15.02.2019

RAPORT PUNE
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA,
PËR VITIN 2018

Kaçanik, Shkurt 2019

Hyrje

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) si trup i përhershëm punues i Kuvendit të Komunës, është formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës 01Nr.60/01-1946/18 më datë: 24.01.2018, në përbërje prej 7 anëtarëve, me përfaqësim si vijon:

- | | |
|--------------------------|---------------------------|
| 1. Kemal Mërseli | Kryesues sipas funksionit |
| 2. Nexhat Loku | anëtar nga PDK, |
| 3. Pranvera Loku- Zharku | anëtare nga PDK, |
| 4..... | anëtar nga LVV |
| 5. | anëtar nga LDK. |
| 6. Hajredin Luta | anëtar nga AAK |
| 7. Hafize Sallahu | anëtare nga NISMA |

Anëtarët e subjekteve të LVV dhe LDK-së nuk i kanë dhënë fillimisht propozimet e tyre për përfaqësuesit e tyre në KPF, për shkak që kërkonin përfaqësim gjithëpërfshirës të te gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës dhe pas konfirmimit të ligjshmërisë së Vendimit nga MAPL.

Me datë 28.02.2018, Kuvendi i Komunës mori Vendim 01Nr. 60/01-5524/18, ashtu që plotësoj KPF-me dy anëtarë dhe atë: nga LVV caktohet, Ekrem Kyçyku, ndërkaq nga LDK, Selim Reka, ndërkaq nga KPF hiqet Hajredin Luta, për t'u zëvendësuar me Albana Tronin nga po i njëjti subjekt politik, për shkak të balansimit gjinor. Kështu KPF nga data e sipër cekur, është në përbërje si vijon:

- | | |
|------------------|-------------------------------------|
| 1.Kemal Mërseli | nga PDK, Kryesues sipas funksionit, |
| 2.Nexhat Loku, | nga PDK, anëtar, |
| 3.Pranvera Loku | nga PDK, anëtare, |
| 4.Ekrem Kyçyku | nga LVV anëtar, |
| 5.Selim Reka | nga LDK anëtar, |
| 6.Albana Troni | nga AAK anëtare, dhe |
| 7.Hafize Sallahi | nga NISMA anëtare. |

Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa, reflekton përfaqësimin e etniteteve politike në Kuvendin e Komunës. Me Komitetin për Politikë dhe Financa, udhëheq Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kemal Mërseli, sipas funksionit që e ka. Mandati i KPF-së është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.

Përgjegjësitë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Sipas nenit 52.2 të Ligjit Nr.03/L-040 - Për Vetëqeverisje Lokale, KPF-a është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë edhe dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesëm, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore të tarifave dhe ngarkesave, planin vjetor të punës së auditimit të brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit të komunës gjatë vitit fiskal si dhe marrjen e raporteve nga kryetari i komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

Aktiviteti i Komitetit për Politikë dhe Financa

Sipas Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutit të Komunës, si dhe kompetencave të bartura nga Kuvendi i Komunës (kompetencës për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë

ndërtimore) KPF-a për gjatë periudhës raportuese është munduar që në suaza të kompetencave të veta t'i realizoj detyrat të cilat janë parashtruar.

Në këtë drejtim, me angazhimin e vet, kjo trupë punuese është munduar të formuloj aso zgjidhje dhe t'i hulumtoj drejtimet me adekuate për zhvillimin e komunës, e më këtë krijimin e kushteve për një jetë sa me të mirë të qytetarëve të komunës. Veprimtarinë e vet e ka orientuar në fusha të ndryshme të cilat me legjislacionin në fuqi i janë lënë në kompetencë. Kjo veprimtari gjatë periudhës raportuese ishte mjaft e gjerë, paraqitën nevoja të ndryshme dhe ky komitet ka arritur në një masë t'i realizoj detyrat të cilat janë parashtruar, por assesi nuk është i kënaqur, pasi nevojat e shumta të qytetarëve të komunës na bëjnë që edhe më tutje të angazhohemi në zgjidhjen e çështjeve jetike. Aktiviteti i Komitetit për Politikë dhe Financa është zhvilluar në takime të rregullta mujore. Gjatë periudhës raportuese ky komitet ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje të rregullta. Mbledhja e parë është mbajtur me 5 anëtarë, pasisë dy subjektet politike LVV dhe LDK nuk i kishin dhënë propozimet e veta për arsye të theksuara, kështu që pas konsultimit me MAPL së mund të thirret mbledhja e KPF me përbërje prej 5 anëtarëve, sepse ka kuorum, është ftuar dhe mbajtur mbledhja e I-r e KPF. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kanë qenë të suksesshme dhe konstruktive. Angazhimi i anëtarëve të KPF-a ka qenë në nivel të duhur. Prezenca e anëtarëve të këtij komiteti ka qenë e rregullt. Në mbledhjet e KPF-së ka mbretëruar një frymë e punës dhe e bashkëpunimit në mes të subjekteve politike të përfaqësuar në këtë komitet. Çështjet që kanë qenë në interes të përgjithshëm të komunës, kryesisht janë aprovuar njëzëri. Për të gjitha mbledhjet e KPF-a është mbajtur Procesverbal i cili ruhet me pedanteri dhe është transparent në çdo kohë. Në takimet e KPF-së janë shqyrtuar çështje të ndryshme në interes të komunës. Për disa çështje të caktuara në këtë komitet janë marrë edhe vendime adekuate apo iu kanë rekomanduar organit vendimmarrës- Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe vendosje apo sa për njoftim. Për të gjitha çështjet të cilat është dashur të debatohet Kuvendi i Komunës në seancën e vet, kjo trupë punuese paraprakisht i ka shqyrtuar dhe e ka dhënë mendimin e vet. Në këtë drejtim ka shqyrtuar 73 çështje për të cilat ia ka Rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim apo marrjen e vendimit adekuat.

Duke marrë parasysh natyrën e çështjeve të cilat janë parashtruar, ka marrë Vendime për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për të cilat paraprakisht ka kërkuar mendimin profesional të drejtorisë përkatëse. Po ashtu në çdo mbledhje të KPF-së është aprovuar Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF-së. Vlen për t'u theksuar se për çdo çështje që ka aprovuar ky komitet, është hartuar akti konform Vendimit të KPF-së.

Në takimet e kësaj trupe punuese kanë marrë pjesë, Kryetari i Komunës apo Nënkryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive Komunale, të cilët i kanë arsyetuar çështjet e propozuara sipas fushë veprimtarisë së tyre. Ekzekutivi i komunës në mbledhjet e KPF-a ka dhënë edhe Informacione tjera të nevojshme shtesë aty për aty, apo në mbledhjen vijuese në formë të shkruar për çështje të ndryshme dhe sipas kërkesave të KPF-a.

Bashkëpunimi i KPF-a me stafin ndërkombëtarë gjatë periudhës raportuese ka qenë në nivelin e duhur. I gjithë materiali i mbledhjes i është dërguar OSBE, të cilët kryesisht i kanë monitoruar mbledhjet. Gjithashtu materiali i mbledhjes i është dërguar edhe OJQ-ve Mbledhjet e KPF-së janë mbajtur me dyer të hapura për çdo të interesuar për me i përcjellë mbledhjet. Punën e kësaj trupe punuese e ka përcjellë edhe zyrtari për Informim, dhe për aktivitetin e zhvilluar të KPF-a ka bërë një përmbledhje të punimeve të çdo mbledhje dhe të njëjtin e ka plasuar në faqen zyrtare të komunës. Ftesa për mbledhje është publikuar çdo herë në faqen zyrtare dhe në tabelë të shpalljeve. Kjo tregon sesa ka qenë transparente kjo trupë punuese ndaj; qytetarëve të komunës, mediave, OJQ, etj. për takimet e KPF dhe aktivitetin tjetër të saj të zhvilluar përgjatë periudhës raportuese.

Çështjet e shqyrtuara

Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë periudhës raportuese i ka shqyrtuar gjithsej, 73 pikë, pa e përfshirë Procesverbalin e mbledhjes së KPF, i cili ka qenë pikë e parë e rendit të punës në çdo mbledhje. Çështjet e shqyrtuara janë materiale të përgatitura nga shërbimet përkatëse profesionale të komunës. Propozim Vendimet kanë qenë të natyrave të ndryshme. Në kuadër të propozim Vendimeve janë shqyrtuar çështje të cilat kanë të bëjnë me rregullativen normative, çështje buxhetore, raporte dhe programe të punës së ekzekutivit të komunës, propozim vendime të ndryshme të shërbimeve përkatëse profesionale, dhe çështje tjera më rëndësi për komunën. Në vazhdim do të i potencojmë çështjet të cilat kanë qenë në shqyrtim të Komitetit për Politikë dhe Financa;

Draft Rregulloret

Në kuadër të kësaj sfere bëjnë pjesë aktet normative të cilat kanë qenë në shqyrtim të kësaj trupe punuese. Në këtë drejtim ky Komitet ka shqyrtuar akte normative të propozuara nga shërbimet përkatëse profesionale, dhe atë:

- Propozim Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Kaçaniku;
- Propozim Rregulloren për Organizimin e punës në Shkolla Filllore dhe të Mesme të Ulëta dhe të Mesme të Larta;
- Propozim Rregulloren për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre; dhe
- Propozim Rregulloren për Tatimin për pronën e paluajtshme për vitin 2019.

Çështjes së akteve normative në përgjithësi kjo trupë punuese i ka kushtuar rëndësi të veçantë; Të Rregullorja e tatimit në pronë, KPF ka propozuar të ulën normat tatimore të shtëpitë e banimit dhe të ato prona të cilat nuk kanë infrastrukturë, pavarësisht zonës I apo II, ndërkaq ka propozuar të ngritën normat tatimore për vilat.

Të Rregullorja për Organizimin e punës në Shkolla Filllore dhe të Mesme të Ulëta dhe të Mesme të Larta, ka sugjeruar që të kenë masa disiplinore edhe për arsimtarë, ndërkaq KPF e sheh të nevojshme që shkollat të kenë psikologë dhe pedagogë, në mënyrë që të zvogëlohen problemet e nxënësve në shkolla.

KPF e ka mirëpritur Rregulloren për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, me qëllim të unifikimit të varrezave, krijimin e një rendi të rregullt të varrimeve, ndërkaq kanë kërkuar të rishqyrtohet çështja e kompensimit të shpenzimeve të varrimit.

Të Propozim Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Kaçaniku, KPF ka kërkuar të shtohet edhe një këshill në qytet, nga dy sa janë propozuar në rregullore, të bëhen tri këshilla në qytet, ndërkaq ka kërkuar të gjenden mundësi për kompensimin e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

KPF i ka dhënë vërejtjet e saja në të gjitha Rregulloret e sipërpërmendur dhe të njëjtat me Rekomandime të këtij komiteti i janë përcjellë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kur jemi të rregullativa normative, pjesë e shqyrtimit nga KPF ka qenë edhe Propozimi për Ndryshim Plotësimin e Statutit të Komunës. Për draftin në fjalë KPF ka debatuar në dy mbledhje, ka dhënë mendimet e tija dhe të njëjtin ia ka adresuar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim apo në procedurë të mëtutjeshme-debatit publik me qytetarë të komunës.

Kontribut të veçantë në çështjen e rregullativës normative, KPF-a ka dhënë edhe në Debate publike të organizuara më qytetarë në çështjen e ndryshim plotësimeve të Statutit të komunës.

Draftet-Buxhetore dhe Raportet Financiare

Si çdo herë kur janë shqyrtuar çështjet buxhetore edhe në vitin 2018, KPF-a i ka kushtuar rëndësi të veçantë; Kornizën afatmesme të shpenzimeve të Komunës së Kaçanikut për vitet: 2018-2019 dhe Buxhetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020-2021, Korniza afatmesme e shpenzimeve është dokument fillestar për hartimin e buxhetit të komunës. Dokumente përcjellëse që i kanë paraprirë hartimit të buxhetit për vitin 2019 janë: Qarkoret e brendshme buxhetore. Vetëm për Draftin kornizë dhe dokumentet tjera përcjellëse- qarkoret buxhetore, KPF-a ka debatuar gjerë e gjatë, e ka dhënë mendimin e vet, ndërkaq Draftin Kornizë ia ka Rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim. Vlen të përmendet së për Qarkoret buxhetore dhe për Draftin kornizë janë mbajtur edhe dëgjime publike me qytetarë të komunës, ku përpos organeve të administratës komunale kanë qenë të obliguar të marrin pjesë edhe anëtarët e KPF-a, të cilët në këtë drejtim e kanë dhënë kontributin e tyre.

Projekt Buxheti i Komunës për vitin fiskal 2019 dhe kërkesat e projektuara për vitet, 2020 dhe 2021

Në këtë dokument, KPF-a i ka dhënë propozimet e veta për projektet që duhet të hyjnë në realizim më buxhetin afatmesëm të komunës për vitet: 2019-2021. Në këtë drejtim, KPF e ka aprovuar Buxhetin e Komunës për vitin 2019 në shumë: 8.381.634 €, dhe Projektionet për vitet 2020-2021, në shumat buxhetore : 8.651.903 € për vitin 2020 dhe: 8.964.018 € për vitin 2021. Edhe në këtë plan afatmesëm buxhetor, KPF-a i ka futur synimet e veta për secilën veprimtari konform Statutit të Komunës, dhe çdo herë duke iu dhënë prioritet Listës së Projekteve Kapitale. Në këtë drejtim ka aprovuar një Listë me 64 Projekte Kapitale, duke iu dhënë prioritet atyre projekteve që janë me të nevojshme dhe emergjente për komunitetet në shumën, 2,012,431.00€. Duke marrë për bazë faktin se më buxhetin e ndarë për projekte kapitale, nuk mund të realizohen të gjitha projektet e aprovuara sepse disa nga projektet kanë hyrë në listë vetëm sa për t'u koduar, mirëpo gjithëherë është menduar në angazhimin e organeve të komunës, në nivelin qendror dhe më gjerë për gjetjen e donacioneve më qëllim që projektet e aprovuara të realizohen. Kontributin e vet për çështjen e buxhetit të komunës, KPF-a e ka dhënë edhe në debatet e organizuara më qytetarë, ku një debat publik për çështje të buxhetit të komunës është organizuar nga kjo trupë punuese. Pas vlerësimit të thukët nga KPF-a, Projektbuxheti i Komunës për vitin fiskal 2019 dhe Kërkesat e projektuara për vitin 2020-2021, i është përcjellë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Raportet Financiare të aprovuara nga KPF

- Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017,
- Raportin Financiar të Komunës së Kaçanikut, për periudhën: janar-mars, 2018,
- Raportin e realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën: janar-qershor, 2018,
- Raportin e realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën, janar-shtator 2018,
- Raporti Final i Auditivit të Përgjithshëm dhe Plani i Veprimit lidhur me Pasqyrat vjetore financiare, për vitin e përfunduar me 31.12.2017.

Të çështja e raporteve financiare, vlen të përmendet se, KPF-a, në disa sektorë vlerëson se janë përmbushur objektivat në pajtim me planifikimin e të hyrave vetjake komunale, ndërsa në disa sektorë në raport më planifikimin ka qenë më pak i kënaqur dhe këto pakënaqësi kjo trupë

punuese i ka shprehur sa herë të ekzekutivi i komunës dhe sugjerimet e KPF-a kanë ndikuar në një angazhim pak më të madh të sektorëve të caktuar që inkasimi i të hyrave vetjake komunale në sektorë të caktuar të shënoj ngritje. Komiteti për Politikë dhe Financa e vlerëson pozitivisht realizimin e të hyrave vetjake nga Tatimi në Pronë, ndërsa është pritur ngritje e inkasimit të të hyrave nga lejet ndërtimore. Gjithashtu të taksat për leje ndërtimi, shfrytëzimin e pronës komunale, taksat në bujqësi e pylltari, gjobat nga inspektorati dhe të shitja e masës drusore, KPF ka shprehur shqetësimet e tija së inkasimet janë të vogla. Të gjobat nga inspektorati, edhe pse në vitin 2018 ka pasur pak të hyra, KPF nuk është i kënaqur sa duhet me inkasimin e realizuar. Në Raportet financiare, vlen të cekët se KPF-a ka kërkuar sqarime shitesë të shpenzimeve buxhetore në programe të caktuara buxhetore sa herë që janë shqyrtuar raportet financiare aty ku ka pasur paqartësi, ndërsa për çdo shpenzim që ka menduar se është i madh apo më pak i arsyeshëm në raport më nevojat të tjera, ka dhënë vërejtjet e tija, ndërkaq i ka mbështetur rekomandimet e Zyrës Gjenerale të Auditorit për zbatimin e rekomandimeve të paraqitura si në raportin e vitit 2017. Kur jemi të raportet financiare, vlen të përmendet se KPF-a ka kërkuar informacion për procedurat e udhëhequra të tenderimit, ndërkaq kanë sugjeruar Kryetarit të Komunës që Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse komunale të angazhohen lidhur me projektet për të cilat janë zhvilluar procedurat tenderuese, të realizohen në afatet e përcaktuara kohore, ashtu siç e parasheh Ligji i Prokurimit Publik, në mënyrë që mos të ngelin mjete në suficit buxhetore në suficit.

Propozim Vendimet për çështje financiare

Propozim Vendimeve për çështje financiare, KPF-a iu ka kushtuar një rëndësi e veçantë, në këtë drejtim në pamundësi të realizimit të disa projekteve kapitale apo çështje të tjera, është intervenuar në mjetet që nuk kanë arritur të realizohet sipas Listës së projekteve kapitale nga vitet paraprake, për t'i bartur në ndonjë projekt tjetër kapital. Ndërkaq me qëllim që mos të ngelin mjete buxhetore në suficit, KPF ka aprovuar Propozim Vendimi për rialokimin dhe transferin e mjeteve të projekteve kapitale sipas buxhetit të vitit 2018. Nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve ka lejuar mjete buxhetore për realizimin e projekteve të drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, dhe të Projekteve të drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, me një shpërndarje për projekte sipas Planit buxhetor të propozuar nga këto drejtori, masën drusore të konfiskuar ka vendosur me ua ndarë shkollave, edhe pse ka pasur propozim që masën drusore me ua ndarë skamnoreve. Kur jemi të konfiskimi i masës drusore, KPF ka shprehur shqetësim për dëmtimin dhe shkatërrimin e pyjeve në masë të madhe, ndërkaq në anën tjetër, masa drusore e konfiskuar është shumë e vogël apo vetëm 54m³. Rrëndësi e veçantë në shpërndarjen e subvencioneve të DAK iu është dhënë kompensimit të udhëtimeve të nxënësve të shkollave të mesme, ndarjen e bursave, financimin e SHKA, Klubeve Sportive dhe OJQ, krejt këto ndarje me u bërë në bazë të Rregullores për subvencione dhe transfere.

Për çdo ndryshim buxhetor të propozuar, KPF-a ka kërkuar sqarime të nevojshme nga propozuesi pse ka ardhur deri të ndryshimet buxhetore, e në veçanti ka kërkuar arsye të projektet kapitale që kanë qenë në listë për realizim e nuk janë realizuar në kohën e përcaktuar.

KPF, pos tjerash ka kërkuar në vazhdimësi sqarime të nevojshme nga ekzekutivi i komunës se deri ku kanë arritur realizimi i projekteve: Ndërtimit të Palestrës Sportive, dhe Ndërtimi i Stadiumit të qytetit "Besnik Begunca" dhe projekte tjera më rëndësi për komunën.

Nga çështjet financiare ka aprovuar këto Propozim Vendime:

Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga vitet paraprake, për shpenzim me buxhetin e vitit 2018; Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas programeve dhe kodeve të projekteve kapitale; Draft – Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut,

për vitet 2019 - 2021; Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017; Plan i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2017; Propozim Vendimi për transferimin/rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit 2018; Propozim Vendim për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020-2021; Propozim Vendim për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës për vitin 2018.

Për të gjitha këto çështje, janë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet nga KPF-a dhe të njëjtat i janë Rekomanduar, Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratimin e tyre.

Propozim Vendimet për çështje tjera më rëndësi për komunën që ka shqyrtuar KPF

Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRU “Bifurkacioni” – Sh.A. Njësia Kaçanik; Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” – Sh.A. Njësia Kaçanik; Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. Kaçanik; Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për emërimin ,riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale; Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesës së parcelës kadastrale Nr. 00246-0, Z.K. Soponicë, e evidentuar në emër të Esat Xhemal Guri nga f.Nikaj për zgjerimin e lokacionit të varrezave të dëshmorëve; Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës kadastrale Nr. 01507-0 në vendin ‘Guri i Zi’ Z.K. Biçec, PSH, Ekonomia Pyjore në Kaçanik, për zgjerimin e lokacionit të varrezave të dëshmorëve; Propozim Vendimi për iniciimin e procedurave për themelimin e Teatrit të Qytetit të Kaçanikut, si institucion me status publik; Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës; Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës; Propozim Vendimi për miratimin e planifikimit të rrugës Kaçanik- Ivajë- Shtrazë, sipas situacionit të bashkangjitur të lëndës dhe inkorporonim e saj në Planin Zhvillimor Komunal; Propozim Vendimi për dhënien në menaxhim të përkohshëm të tregut të gjelbër, Ndërmarrjes Publike “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. Kaçanik”; Propozim Vendimi për dhënien e Pëlqimit, Organizatorit të Fondacionit “Idriz Seferi” për gdhendjen në shkëmb të figurës – heroit kombëtar, Idriz Seferi të Gryka e Kaçanikut; Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale; Propozim Vendimi për fillimin e Procedurave për rishqyrtimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe harmonizimin e tij me ligjin e planifikimit hapësinor 04/L-174 ; Propozim Vendimi Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim afatshkurtër; Propozim Vendim për formimin e Komisionit për hartimin e Draft-Rregullores për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për dhënien me qira të banesave në pronësi të Komunës; Propozim Vendim për Themelimin e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara; Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, parcelën kadastrale Nr. 00587-2, ZK në Kaçanik, Agjencisë të punësimit të Republikës së Kosovës; Propozim Vendimi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal; dhe Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, shkollave të Komunës;

Propozim vendimet e propozuara kryesisht janë të natyrave të ndryshme me rëndësi për komunën. E një rëndësi të veçantë është: Propozim Vendimi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, kur dihet se ka pasur devijime të PZHK nga autostrada etj. kështu që është nevojë e kohës të bëhet një plan i mirë dhe i qëndrueshëm me ekspertë të lëmit përkatëse qoftë nga jashtë apo nga brenda, pavarësisht implikimeve buxhetore. Gjithashtu me një rëndësi në

aspektin financiar të komunës është edhe Propozim Vendimi për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, ku paraprakisht KPF ka debatuar për formimin e komisionit vlerësues për zhvillimin e procedurave për dhënien e këtyre pronave në shfrytëzim afatshkurtër apo afatgjatë. Për të gjitha Propozim Vendimet e lartcekura, KPF ka debatuar gjerë e gjatë, ka kërkuar mendimin profesional nga shërbimet përkatëse profesionale, dhe të njëjtat me Rekomandime të KPF iu kanë proceduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim, me përjashtim të Propozimit me Nr. 10 Propozim Vendimi për miratimin e planifikimit të rrugës Kaçanik- Ivajë-Shtrazë, sipas situacionit të bashkangjitur të lëndës dhe inkorporimin e saj në Planin Zhvillimor Komunal, pasi që lënda nuk ka qenë e kompletuar, kështu kjo lëndë është refuzuar, ndërkaq Propozim Vendimi për lirin nga pagesa e Tatimit në Pronën për personat e verbër e ka hequr nga rendi i punës për shkak se nuk ka qenë e sqaruar sa duhet bazës ligjore.

Vendimet e miratuara nga KPF

Komiteti për Politikë dhe Financa, në kuadër të fushë veprimtarisë së vet ka marrë 8 vendime për ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ndërkaq 1 vendim është rishqyrtuar për shkak të disa gabimeve teknike të sipërfaqes së pronës. KPF-a sa herë që i adresohen propozim vendime të kësaj natyre, sugjeron ekzekutivit të komunës që të kenë kujdes për mos cenimin e Planit Zhvillimor të Komunës në njërin anë dhe në anën tjetër, sugjeron që të ruhet tokat bujqësore, sepse fondi i tokave bujqësore në komunën e Kaçanikut është shumë i vogël.

Planet dhe Raportet e Punës dhe çështje të tjera

Nga Planet dhe Raportet e Punës kjo trupë punuese ka vënë në shqyrtim;

- Raportin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për periudhën, janar-dhjetor, 2017;
- Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2018;
- Plani i Mbrotjtjes nga Zjarri për Komunën e Kaçanikut;
- Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2019;
- Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2019;
- Plani Lokal i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Kaçanikut, 2019-2021;
- Plani i Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019;
- Plani i Veprimit për Transparencë, për vitin 2019;
- Plani i Integritetit të Komunës së Kaçanikut, për vitet 2019-2021; dhe
- Raporti i Shoqatës së Bjeshkatarëve Alpiniste “Kaçaniku 2015” për shpenzimin e mjeteve financiare nga subvencionet.

Këtyre çështjeve KPF iu ka kushtuar rëndësi të veçantë, ashtu që i ka shqyrtuar në detaje të gjitha raportet dhe planet e punës të potencuara si më lartë, ka dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e veta dhe të njëjtat ia ka rekomanduar Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe aprovim apo sa për njoftim. Vlen të përmendet të çështja e raportit të shoqatës së bjeshkatarëve, KPF ka sugjeruar që në të ardhmen njëjtë të veprojnë edhe përfituesit tjerë të subvencioneve dhe transfereve, ashtu që për mjetet e përfituara nga subvencionet dhe transferet, të hartohet raport me shkrim për shpenzimin e tyre dhe ato raporte t'i dërgohen organeve të komunës.

Çështjet të tjera me rëndësi për komunën që janë shqyrtuar nga KPF

- Informatë për dëmet e shkaktuara nga të reshurat e shiut;
- Informatë e MAPL për kualifikimin e Komunës së Kaçanikut për përfitimin e Grantit të

Performancës, në bazë të vlerësimit të shërbimeve cilësore me qytetarët e komunës, për vitin 2016;

- Informatë e DAK për Fillimin e vitit shkollor 2018/2019;
- Informatë për Përfundimin e vitit shkollor 2017/2018; dhe
- Informatë- Përmbledhja e Rezultateve për vitin 2017, për Grantin e Performancës- Komuna Kaçanik.

Kur jemi të Granti i Performancës, KPF është falënderuese që komuna ka arritur të fitoj grantin e performancës në bazë të aktiviteteve të punës së komunës, ndërkaq ka sugjeruar që aty ku ka mundësi komuna me rritur grantin e performancës së komunës, ai aktivitet tani e tutje të zhvillohet, si të çështja e shqyrtimit të Raportit të Auditorit të brendshëm nga KK, etj.

Kur jemi të çështja e mirëmbajtjes së rrugëve lokale, KPF ka kërkuar nga DSHPE që të hartoj një Informatë për mirëmbajtjen e rrugëve lokale në sezonin e dimrit dhe ajo informatë t'i dërgohet KK, për informim. KPF-a i ka shqyrtuar në detaje të gjitha Informata e theksuara si më lartë, ka dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e veta dhe të njëjtat ia ka adresuar KK procedurë sa për informim.

Punët dhe detyrat e punës së KPF-a përgatiten nga një zyrtar i punësuar në Shërbimin Profesional të Kuvendit të Komunës dhe asistentes së Kryesuesit të Kuvendit. Me angazhimin e këtyre zyrtarëve, përgatiten mbledhjet e KPF-a, përgatitet materiali i nevojshëm, përpilohet; Procesverbali i mbledhjes, Vendimet dhe Shkresat tjera të dalë nga mbledhjet e kësaj trupe punuese dhe të njëjtat arkivohet për nevojat e Shërbimit Civil të Komunës. Të njëjtat punë këta zyrtarë kryejnë edhe për Kuvendin e Komunës dhe trupat tjerë punuese të KK.

Përfundim

Komiteti për Politikë dhe Financa është i vetëdijshëm se gjatë periudhës raportuese nuk ka qenë në gjendje të realizoj të gjitha synimet e veta në drejtim të zgjedhjes së çështjeve si pasojë e së kaluarës dhe me një buxhet të limituar, por angazhimi i tyre jep shpresë se në një të ardhme të afërt dhe me një angazhim permanent në gjetjen e donacioneve etj. si dhe shqyrtimin e mundësive për shtimin e të hyrave vetjake komunale, gjendja do të përmirësohet. KPF është i mendimit që veprimtarinë e vet në të ardhmen do t'i orientoj në arritjen synimeve në realizimin e projekteve kapitale më rëndësi ekonomike, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Urban dhe në Planin Zhvillimor Komunal dhe realizimin e projekteve kapitale më prioritet sipas Listës së aprovuar për vitin 2019, ndërkaq vlerëson se ka nevojë të bëhet më tepër në këto segmente:

Zhvillimin ekonomik të komunës, Shtimin e të hyrave vetjake komunale apo së paku realizimin e atyre që planifikohen, Zbutjen e papunësisë, Ngritjen e mirëqenës sociale, Çështjen e banimit social, Kujdesin primar shëndetësor, Ngritjen e cilësisë në arsim, Përmirësimin e infrastrukturës shkollore, Ndërtimin e objekteve shkollore të reja, Ndërtimin e katit të dytë të SHMP" Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka", Përfundimin e objekteve kulturore dhe sportive; Hallës së sporteve dhe të Stadiumit të qytetit, Ofrimin e Shërbimeve publike sa më cilësore, Nevojën për shtimin e subvencioneve dhe transfereve në sektorët: Arsim, Shëndetësi dhe Bujqësi, Përmirësimin e infrastrukturës fizike (rrugë, ujësjellës dhe kanalizim), Mbrojtjen e ambientit, Zbatimin e rregullave të ndërtimit sipas standardeve, etj.

Shkurt, 2019

Për Komitetin për Politikë dhe Financa
Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-5181/19
Kaçanik: 27.02.2019

Në bazë të nenit 55 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Draft Planit të Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2019, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 27 Shkurt 2019, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE TË KOMITETIT PËR
KOMUNITETE PËR VITIN 2019

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete, për vitin 2019, i propozuar nga Komiteti për Komunitete, me tekstin e mëtejme, Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019.
2. Në Planin e Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2019, janë paraqitur objektivat e këtij Komiteti, arsyeshmëria e tyre, adresimi, përkrahja e nevojshme dhe koha e implementimit të aktiviteteve.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është : Plani i Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2019, 01Nr. 60/01-5181/19 i përmbledhur në gjithsej, 3 faqe +ballina..
4. Për realizimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete do të kujdeset; Komiteti për Komunitete dhe organet tjera relevante të komunës.


Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Komiteti për Komunitete dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01/Nr 6061-5181-----2019

PLANI I PUNËS I KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2019

Kaçanik, 2019

Komiteti për komunitete

- Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale ,praktikave dhe aktiviteteve për ti siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve të komunës masat që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar ,shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor ,fetar dhe gjuhësor ,si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës .

Përbërja e Komitetit për Komunitete

Nr	Emri e mbiemri	Përfaqësimi	Telefoni	E-mail adresa
1	Lirije Luta	Anëtare e Kuvendit PDK Kryesuese e Komiteteit për Komunitete	044/824-768	lirije.qeli@ks-gov.net lira22@live.com
2	Nazife Krasniqi	Anëtare e Kuvendit LDK	044/ 693- 670	xifja62@hotmail.com nazife.krasniqi@rks-gov.net
3	Shemsedin Abazi	KLMDNJ	044/224-685	shabazi@live.com
4	Elmihane Krasniqi-Malsiu	Handikos	044/235- 717	handikoskaganik@hotmail.com
5	Hajredin Luta	Anëtarë i Kuvendit Kandidat i panvarur	044 /227- 595	Hajredin_luta@outlook.com
6	Kaltrina Tafili	Anëtare e Kuvendit LVV	045/271-880	Kaltrinatafili14gmail.com
7	Naim Hysa	Kryqi i Kuq	044/224-881	kacanic@rdcross-ks.org

Temat dhe aktivitetet e komitetit per komunitete per vitin 2019

Nr.	Tema	Aktivitetet	Përkrahja e nevojëshme	Kalandari Kohor 2019
1.	Banimi Social	1. Vizitë tek disa familje me raste të rënda sociale . 2. Monitorimi i komisionit gjatë ndarjeve të banesave .	-Kuvendi Komunal; -Qendra për punë sociale ;	Shkurt-Dhjetor
2.	Zgjedhja e këshillave të fshatërave	1. Monitorimi i procesit zgjedhor të këshillave të fshatërave . 2. Inkurajimi i femrave për pjesëmarrje në këto zgjedhje . 3. Inkurajimi i femrave për kandidim .	-Kuvendi Komunal Kaçanik; -OJQ-ët	Shkurt-Dhjetor
3.	Grantet për Komunitete	1.Monitorimi i ndarjeve të grantëve (subvencioneve) 2.Monitorimi i përfutueseve të grantëve .	KK.Kaçanik	Shtator – Dhjetor
4.	Vazhdimi i shkollimit të femrave	1.Takim me gratë e interesuara. 2.Shyrtimi i mundësive për lirin e pagesave .	Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës; OJQ-të	Shtator – Dhjetor

5.	Gjendja aktuale e QKMF-ës	1. <i>Takim me drejtoreshën e QKMF-ës.</i> 2. <i>Monitorimi i Barnatoreve.</i> 3. <i>Monitorimi i QMF-ve.</i> 4. <i>Kujëstaria ndërrimi i natës në QKMF</i>	Drejtoria e Shëndetësis dhe Mirëqenjes Sociale . Drejtori i qendrës së QKMF-ës	Shkurt- Dhjetor
6.	Të drejtat e fëmijëve nëpër Shkolla	1. <i>Takim me drejtorat e Shkollave</i> 2. <i>Takim me këshillin e prindëve</i> 3 <i>Takim me disa përfaqësues të nxënësve</i>	Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës	Mars-Qershor
7.	Monomentet Kulturore	<i>1. Vizitë monamenteve Kulturore</i>	Komuna Kaçanik	Mars - Dhjetor

Vrejtje : Përveç aktiviteteve të parapara në planë të punës , temave të lartëcekura ne sipas nevojës mund të zhvillojmë edhe ndonjë aktivitet shtesë.

Grupi punues :

1. Elmihane Krasniqi-Malsiu
2. Naim Hysa
3. Nazife Krasniqi
4. Hajredin Luta
5. Kaltrina Tafili
6. Shemседin Abazi
7. Lirije Luta

Kaçanik- Shkurt, 2019


Kryesuesja: Lirije Luta